



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Kuvendi – Skupština - Assembly

Legjislatura III

Seanca e Kuvendit

P- 010

Prishtinë, më 13 mars 2008, në orën 14:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

NGA SEANCA E KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 13 MARS 2008

Seancën e kryesoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Ibrahim Gashi**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 70 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryetari i njoftoi deputetët se në bazë të Vendimit të Kuvendit për shmangie nga Rregullorja e Punës për shqyrtimin dhe miratimin e ligjeve të identifikuara në Propozimin gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës dhe legjislacionin e ndërlidhur me të, seanca e sotme do t'i zhvillojë punimet me këtë

R e n d d i t e:

1. Shqyrtimi i dytë i grupit të dytë të projektligjeve nga Propozimi i Marti Ahtissarit:

- 1.1 Projektligji për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës,
- 1.2 Projektligji për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës,
- 1.3 Projektligji për Forcën e Sigurisë së Kosovës,
- 1.4 Projektligji për themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës,
- 1.5 Projektligji për të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarët e tyre,
- 1.6 Projektligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë të vitit 2008,
- 1.7 Projektligji për financat e Pushtetit Lokal,
- 1.8 Projektligji për Aviacionin Civil të Kosovës,

- 1.9 Projektligji për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, dhe
1.10 Projektligji për kompetencat, përzgjedhjen dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe të prokurorëve të EULEX-it në Kosovë.

Komisioni ad-hoc i ka shqyrtuar projektligjet dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin, me rekomandime.

Kryetari ftoi kryesuesin e Komisionit ad-hoc, Fehmi Mujota, t'i arsyetojë rekomandimet për të gjitha projektligjet e shqyrtuara.

Fehmi Mujota tha se Komisioni ad-hoc, në bazë të mandatit me Vendimin e Kuvendit të Kosovës për shmangie nga Rregullorja e Punës për shqyrtimin dhe miratimin e ligjeve të identifikuar në Propozimin gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës dhe legjislacionin e ndërlidhur me të, sipas procedurës së veçantë, të datës 15 shkurt 2008, në mbledhjen e mbajtur më 12 mars 2008, ka shqyrtuar projektligjet e pakos së dytë nga Propozimi i Ahtisarit.

Komisioni ka siguruar pajtueshmërinë e brendshme të projektligjeve dhe harmonizimin gjuhësor.

Komisioni, gjatë ditës së djeshme i ka shqyrtuar projektligjet e grupit të dytë nga Propozimi i Ahtisarit dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Komisioni ka rekomanduar 15 ndryshime, që nuk janë ndryshime përmbajtjesore, por janë ndryshime që rregullojnë pajtueshmërinë gjuhësore në mes të ligjeve dhe bëjnë një lloj rregullimi ose strukturimi gjuhësor.

Në fund, deputeti Mujota, në emër të Komisionit ad hoc, propozoi që Kuvendi ta miratojë grupin e dytë të projektligjeve nga Propozimi i Marti Ahtissarit me rekomandimet e komisionit.

Kryetari kërkoi nga grupet parlamentare që të deklarojnë për Raportin dhe rekomandimet e Komisionit ad hoc.

Ramë Buja, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së tha se e aprovojnë Raportin e Komisionit ad hoc dhe në tërësi të gjitha ligjet e grupit të dytë nga Propozimi i Ahtisarit.

Lutfi Haziri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së deklaroi se mbështet amendamentet e propozuara nga Komisioni ad hoc, por në amendamentin 2 në Projektligjin për financimin e pushtetit lokal, në shtojcën për komunat "...Graçanicë" të zëvendësohet me emrin e komunës "Leposaviq".

Ibrahim Makolli, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së tha se mbështet Raportin e Komisionit ad-hoc lidhur me pjesën e dytë të ligjeve nga Pakoja e Ahtisarit.

Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së tha se mbështet Raportin e Komisionit ad-hoc dhe miratimin e ligjeve të propozuara.

Pastaj, kryetari procedoi me votimin e amendamenteve të propozuara nga Komisioni ad hoc, veç e veç, për secilin Projektligj.

Kuvendi miratoi këto amendamente: Amendamentet nr. 1 dhe 2 në **Projektligjin për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Kosovës**; Amendamentet nr. 1, 2 dhe 3 në **Projektligjin për Forcën e Sigurisë së Kosovës**; Amendamentet nr.1 dhe 2 në **Projektligjin për themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës**; Amendamentet nr. 1, 2, 3, 4, dhe 5 në **Projektligjin për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës**; Amendamentin nr. 1 në **Projektligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, të vitit 2008**; Në **Projektligjin për financat e pushtetit lokal të plotësohet shtojca me numrin e banorëve të komuniteteve pakicë në komunat Zubin Potok, Zveçan dhe Leposaviq**; Amendamentet nr. 1 dhe 2 në **Projektligjin për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës** dhe Amendamentet nr. 1 dhe 2 në **Projektligji për kompetencat, përzgjedhjen dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe të prokurorëve të EULEX-it në Kosovë.**

Në fund, **Kryetari** i hodhi në votim Projektligjet dhe amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----83;
Kundër----- 7;
Abstenime-----5.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi grupin e dytë të ligjeve nga Propozimi i Marti Ahtissarit, si vijon:

1. Ligjin për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës,
2. Ligjin për Ministrinë e Forcës së Sigurisë të Republikës së Kosovës,
3. Ligjin për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës,
4. Ligjin për themelimin e Këshillit të Sigurisë të Republikës së Kosovës,
5. Ligjin për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës,
6. Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë të vitit 2008,
7. Ligjin për financat e pushtetit lokal,
8. Ligjin për Aviacionin Civil të Kosovës,
9. Ligjin për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, dhe
10. Ligjin për kompetencat, përzgjedhjen dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe të prokurorëve të EULEX-it në Republikën e Kosovës.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën në orën 14: 40 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup

KRASNIQI

Përgatiti:
Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale